

KONTRATA SOCIALE KORÇË

RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE SHTATOR 2022-SHTATOR 2023

**RAPORTI I TRETË I MONITORIMIT
PËRGATITUR NGA:
GRUAJA NË ZHVILLIM KORÇË**

**RAPORTI MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE
TË KONTRATËS SOCIALE**

BASHKIA KORÇË

POP – PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE

Shtator 2022 – Shtator 2023

Përgatiti raportin: Shoqata “Gruaja në Zhvillim Korçë”

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe National Endowment for Democracy.

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë
- Qendra “Për Zhvillimin e Shoqërisë Civile”, Durrës
- Qendra Rinore Vlorë
- Qendra “Epoka e Re”, Fier
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë
- Qendra Rinore për Progres, Kukës
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës
- Tjetër Vizion, Elbasan
- Shoqata “Gruaja në Zhvillim Korçë”, Korçë

Ky Raport është përgatitur nga Shoqata “Gruaja në Zhvillim Korçë” në kuadër të projektit POP 2023 “Kontrata Sociale si mjet efektiv për pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje në nivel vendor dhe transparenca” dhe nuk përfaqëson qëndrimin e Olof Palme International Center dhe National Endowment for Democracy. Gjetjet dhe qëndrimet në raport janë përgjegjësi vetëm e autorëve.

Tabela Përmbledhëse

SHKURTIME	4
FALENDERIME.....	5
HYRJE	6
METODOLOGJIA.....	8
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	9
ANALIZA E GJETJEVE PËR SECILIN PRIORITET SIPAS KONTRATËS SOCIALE.....	12
GJETJET NGA MONITORIMI DHE INFORMACIONI I BASHKISË KORÇË.....	12
<i>PRIORITETI 1:.....</i>	<i>12</i>
<i>PRIORITETI 2 :.....</i>	<i>14</i>
<i>PRIORITETI 3:.....</i>	<i>15</i>
<i>PRIORITETI 4:.....</i>	<i>16</i>
<i>PRIORITETI 5:.....</i>	<i>18</i>
<i>PRIORITETI 6 :.....</i>	<i>21</i>
VLERËSIM I THELLUAR DHE PËRFUNDIME	21
ANEKSE.....	22
<i>ANEKS 1. PARAQITJA GRAFIKE E REZULTATEVE.....</i>	<i>22</i>
<i>ANEKS 2. KONTRATA SOCIALE E DETAJUAR.....</i>	<i>23</i>
REFERENCA.....	24

Shkurtime

NE	Ndihmë Ekonomike
NJA	Njësi Administrative
URB	Zonat Urbane
RUR	Zonat Rurale
GZHK	Shoqata “Gruaja në Zhvillim Korçë”
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
KB	Këshilli Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
PAK	Personat me aftësi të kufizuar
POP	Përballja e Ofertave Politike
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
COVID - 19	Pandemia e Virusit Korona
Kontrata Sociale	6 prioritetet kryesore të identifikuara nga qytetarët gjatë 2021
AZHRB	Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural

Falenderime

Për të hartuar botimin e tretë të Raportit të monitorimit të Kontratës Sociale, bashkëpunuam me shumë aktorë e institucione. Falenderojmë Bashkinë Korçë dhe drejtoritë përkatëse, për vënien në dispozicion të informacioneve të kërkuara, Kryetarin e Bashkisë z. Sotiraq Filo, Drejtoreshën e Kabinetit Bashkia Korçë znj. Brunilda Prifti, Kryetaren e Këshillit Bashkiak znj. Ana Verushi për disponibilitetin e tyre në komunikimet e vazhdueshme përgjatë monitorimit të Kontratës Sociale të Korçës.

Falenderojmë në mënyrë të veçantë qytetarët që pranuan t'i përgjigjeshin pyetjeve tona, anëtarët e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP), si edhe një falenderim për stafin dhe vullnetarët e Shoqatës “Gruaja në Zhvillim Korçë”, të cilët që prej momentit të nënshkrimit të Kontratës Sociale kanë qenë në monitorim të vazhdueshëm të punës së Bashkisë Korçë dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak.

Gjithashtu, dëshirojmë të falenderojmë Olof Palme International Center dhe NED – National Endowment for Democracy për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohesh ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.

Hyrje

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP” synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë vendore, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Gjatë vitit 2019 janë hartuar kontratat sociale për 9 bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec dhe Pukë), ndërsa tre bashki të reja u bënë pjesë e këtij procesi në vitin 2021, përmes replikimit të procesit edhe në bashkitë e Elbasanit, Vau i Dejës dhe Korçë duke e çuar në 12 numrin e bashkive nën monitorimin e organizatave të shoqërisë civile anëtare të rrjetit POP. Gjatë periudhës shtator 2022-2023 për të katërtin vit me radhë, rrjeti POP monitoroi zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen te njëri – tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Ky është viti i katërt i monitorimit të punës së pushtetit vendor për përfshirjen e prioriteteve të qytetarëve dhe përmbushjen e Kontratës Sociale.

Organizata Gruaja në Zhvillim Korçë u bë pjesë e Rrjetit POP në vitin 2021 duke filluar aktivitetet e saj në muajin maj 2021.

Kontrata Sociale për Bashkinë Korçë u firmos në datë 27 korrik 2021¹ nga Kryetari i Bashkisë Korçë z. Sotirag Filo dhe përfaqësuesja e Shoqatës “Gruaja në Zhvillim Korçë”.

Gjatë vitit 2021, projekti i POP vazhdon me “Kontrata Sociale si një mjet për të forcuar marrëdhëniet mes qytetarëve dhe pushtetarëve”, duke vijuar monitorimin dhe bashkëpunimin mes aktorëve kryesorë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve.

Kontrata Sociale për Bashkinë Korçë² përmban 6 prioritete që qytetarët e Korçës identifikuan gjatë muajve maj-qershor 2021. Shoqata “Gruaja në Zhvillim Korçë” (GZHK), synoi të krijojë dhe promovojë mekanizma qytetare në funksion të përmirësimit të demokracisë lokale, duke angazhuar qytetarët, stafin e Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak të dialogojnë dhe të punojnë për realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale. GZHK mundësoi vlerësimin dhe monitorimin e performancës së administratës lokale dhe të zgjedhurve vendorë duke promovuar dialog dhe bashkëpunim në nivel vendor. Në Bashkinë Korçë, Kontrata Sociale bëri që komuniteti të ketë një mjet për të mbajtur stafin e Bashkisë dhe Këshillin Bashkiak përgjegjës për adresimin e prioriteteve të tyre. Në prag të Zgjedjeve vendore të 14 Maj 2023, advokoi me kandidatët për Kryetarë Bashkie, të forcave të

¹ Firmosja e Kontratës Sociale për Bashkinë Korçë:

<https://www.facebook.com/POPNetworkAlbania/photos/pcb.1022029351791444/1022027958458250/>

² Kontrata Sociale për Bashkinë Korçë:

https://popnetwork.al/.../07/Kontrata-Sociale_Korca-A3.pdf

ndryshme politik për të futur në agjendat politike edhe prioritetet e Kontratës së re Sociale 2023- 2027, realizuar gjatë vitit 2023.³

Kontrata Sociale 2023- 2027 për Bashkinë Korçë u firmos në datë 8 Maj 2023 nga Kandidati I Partisë Socialiste për Kryetar Bashkie, aktualisht Kryetar i Bashkisë Korçë z. Sotiraq Filo dhe përfaqësuesja e Shoqatës “Gruaja në Zhvillim Korçë”, gjatë një forumi publik.⁴

Në botimin e parë të monitorimit⁵ të Kontratës Sociale 2021- 2023 për Bashkinë Korçë, për periudhën shtator-dhjetor 2021, 25 % e prioriteteve të qytetarëve u adresuan.⁶

Në botimin e dytë të monitorimit⁷ të Kontratës Sociale për Bashkinë Korçë, për periudhën deri në shtator 2022, 58.16 % e prioriteteve të qytetarëve ishin adresuar.

Botimet e Raporteve monitoruese janë ndarë gjerësisht me përfaqësues të Bashkisë Korçë, anëtarë të Këshillit Bashkiak si edhe me qytetarët, duke analizuar arritjet, por edhe punën që duhet bërë për përmbushjen e atyre prioriteteve që janë adresuar pak dhe kanë nevojë për një vëmendje më të shtuar të pushtetit vendor.

GZHK ka lobuar për të gjitha çështjet e Kontratës Sociale, por mundet të veçojmë 2 prej tyre për të cilat kemi patur mbështetje nga qytetarët, të cilët janë përfshirë në një peticion dhe jo vetëm, por edhe kanë qenë konsistentë në kërkesat e tyre, në takimin konsultues për projekt-buxhetin e vitit 2022⁸, në mbledhje të Këshillit Bashkiak, në takime me përfaqësues nga Këshilli Bashkiak dhe drejtoritë përkatëse duke advokuar për:

Rikonstrukcionin e shkollës në fshatin Bulgarec.

Ndërhyrje me investime që përmirësojnë infrastrukturën dhe rrugët dytësore në Lgj.4, Rajoni 1, qyteti Korçë.

*Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale 2021-2023 për periudhën **Shtator 2022 – Shtator 2023.***

Gjatë këtij monitorimi organizata kishte si qëllim:

- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioriteteve të Kontratës Sociale.

³ Kontrata Sociale 2023- 2027

<https://popnetwork.al/kontrata-sociale-2023-2027-pop-korce/>

⁴ Forumi public Korçë:

<https://www.facebook.com/gruajanezhvillimkorce/videos/627488055974002>

⁵ Botimi i parë i monitorimit të Kontratës Sociale, Bashkia Korçë:

https://popnetwork.al/.../01/Raporti_POP_Bashkia_Korce-3.pdf

⁶ Grafikë mbi adresimin e prioriteteve:

<https://www.facebook.com/gruajanezhvillimkorce/photos/a.1572047553053488/3184053258519568/>

⁷ Botimi i dytë i monitorimit të Kontratës Sociale, Bashkia Korçë:

https://popnetwork.al/korce_raporti-monitorues-i-kontrates-sociale-2022/

⁸ Takimi konsultues për projekt-buxhetin e vitit 2022:

<https://www.facebook.com/gruajanezhvillimkorce/photos/pcb.3092209104370651/3092207221037506>

- Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet.
- Të llobojë dhe advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve, sidomos në kuadër të dimensionit social, transparencës dhe llogaridhënies.
- Angazhimin e grupeve qytetare në fushata advokimi dhe lobimi për përmbushjen e prioriteteve të Kontratës Sociale.

Metodologjia

Për të realizuar raportin, GZHK si anëtare e rrjetit POP, u bazua në hapat e mëposhtëm:

- U monitorua puna e Bashkisë Korçë dhe vendimet e Këshillit Bashkiak për periudhën Shtator 2022 – Shtator 2023.
- U organizuan takime me përfaqësues të Drejtorive përkatëse në lidhje me prioritetet e kontratës, të cilat janë në varësi të institucionit të Bashkisë Korçë, administratorë të Njësive Administrative dhe qytetarë të Korçës, mbi ecurinë e punës sa i takon adresimit dhe përmbushjes së prioriteteve të komunitetit të Korçës.
- U realizuan fokus-grupe me anëtarë të komunitetit në 4 Njësi Administrative të Korçës, me pjesëmarrës të cilët kanë qenë pjesë e aktiviteteve të mëparshme dhe kanë kontribuar në përcaktimin e prioriteteve të Kontratës Sociale por edhe me pjesëmarrës të rinj.
- U bënë vizita në terren për të parë nga afër ndërhyrjet e Bashkisë që lidhen me plotësimin e prioriteteve të Kontratës Sociale, duke pyetur edhe qytetarë të rastësishëm në lidhje me këto ndërhyrje.
- U monitoruan vendimet e Këshillit Bashkiak mbi masat e marra nga vetë Bashkia, në lidhje me komunitetin në përgjithësi dhe me disa target-grupe në veçanti, si dhe veprimtaria e anëtarëve të Këshillit Bashkiak, gjithashtu edhe vendimet që kanë lidhje me prioritetet e Kontratës Sociale.
- U analizua dhe monitorua zbatimin faktik të buxheti të Bashkisë për vitet 2022 dhe 2023, si dhe shpenzimet respektive.
- U monitoruan mediat audiovizive dhe ato sociale në lidhje me sa më sipër sipas fushave specifike.

Përmbledhje ekzekutive

Në bazë të monitorimit të Bashkisë Korçë, të kryer nga Shoqata “Gruaja në Zhvillim Korçë” më poshtë renditen disa nga gjetjet kryesore të dala nga ky monitorim. Gjetje nga informacioni i mbledhur në lidhje me 6 prioritetet e Kontratës Sociale – Botimi i tretë i monitorimit Shtator 2022 – Shtator 2023:

Prioriteti 1: Ndërhyrje me investime që përmirësojnë infrastrukturën dhe rrugët dytësore, për bashkinë Korçë.

Janë shtruar dhe riparuar 6,500 m² trotuare në qytet, 3,000 m² më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar dhe janë vendosur 4,382 m² pllaka betoni trotuari, 3,182 m² më shumë se periudha e njëjtë e vitit të kaluar.⁹

- ✓ Në lagjen nr.10 të qytetit, është zbatuar një prej projekteve më të mëdha infrastrukturore të Bashkisë Korçës. Pas përmbylljes së punimeve në rrjetin e kanalizimeve, janë asfaltuar edhe sipërfaqe trotuare. Është përmirësuar ndjeshëm ndriçimi dhe pastrimi në këtë lagje.
- ✓ Janë asfaltuar dhe janë pajisur me trotuarë rrugët e lagjes 4. Kanë ngelur pa përfunduar disa akse për arsyen sepse janë në pronësi private. Gjithsesi mundet të thuhet që ky prioritet është adresuar nga Bashkia e cila është e angazhuar për ti dhënë zgjidhje.
- ✓ Ka përfunduar asfaltimi i të gjitha rrugëve të Lgj.6 dhe Lgj.18.
- ✓ Tek NJA Bulgarec është zgjidhur problemi i ndriçimit në rrugët duke bërë vendosjen e ndriçuesve LED.
- ✓ Janë shtuar ndjeshëm shtyllat dhe sipërfaqet e ndriçuara në fshatin Mborje.
- ✓ Ka përfunduar shtrimi i rrugëve me asfalt si dhe çakullimi i rrugëve të parcelave, në fshatin Mollaj.

Ngelet për tu adresuar në vazhdim asfaltimi i rrugës Bulgarec-Çiflig dhe rruga Bulgarec-Shamoll, të cilat vazhdojnë të jetë ende të paasfaltuara, pra vetëm të çakulluara.

Mbetet problem i pazgjidhur sistemimi i ujrave të zeza në fshatin Mborje, i cili sipas organizimit të ri nuk është kompetencë e NSHP-së, por Bashkia Korçë duhet të gjejë zgjidhjen e këtij problemi.

Duke vlerësuar përmbushjen e prioriteteve në mënyrë progressive për periudhën shtator 2021- shtator 2023, rezulton se prioriteti 1 është përmbushur me 82.8 %.

⁹ RAPORTI I MONITORIMIT BASHKIA KORÇË, JANAR-GUSHT 2023:
<https://docs.google.com/document/d/15p8l77pjE6JmPmKxi-MTI3oG8liHIKIN/edit>

Prioriteti 2: Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar.

- Ka përfunduar rikonstrukcioni dhe shtesa e shkollës së mesme “Themistokli Gërmenji”, projekt me bashkëfinancim me fondet e buxhetit të shtetit dhe Bashkisë Korçë. Projekti përfshin transformimin rrënjësor të ambienteve, ndërtimin e një palestre të re, kabinetin e ri laboratorik dhe vendosjen e të gjitha paisjeve të nevojshme për zhvillimin e mësimin në standarde bashkëkohore. Totali i investimit 98,095,805 Lekë.
- Janë realizuar ndërhyrje në ambientet e shkollës nëntëvjeçare “Asdreni”, si dhe tek këndi sportiv i saj.
- Ka filluar rikonstrukcioni i shkollës së mesme “Ymer Dishnica” (Gjimnazi 3).
- Do fillojë ndërtim shtesë për palestën në shkollën e fshatit Bulgarec.
- Ka përfunduar terreni sportiv tek Shkolla “Isuf Dalipi” në Mollaj, me një investim prej 1,247,702 Lekë. Është realizuar gjithashtu ndarja e ambjenteve të kopshtit nga ato të shkollës dhe është duke u punuar për tualetet.
- Aktualisht po bëhet termoizolimi i jashtëm i Shkollës “Haki Mborja” në fshatin Mborje.

Në lidhje me këtë prioritet ka ngelur pa adresuar rikonstrukcioni i shkollës “Ismail Qemali” dhe të një këndi sportiv në territorin e shkollës të fshatit Mborje.

Duke vlerësuar përmbushjen e prioriteteve në mënyrë progressive për periudhën shtator 2021- shtator 2023, rezulton se prioriteti 2 është përmbushur me 82 %.

Prioriteti 3: Nxitja e politikave të punësimit për të rinjtë nëpërmjet incentivave për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës për ta.

Vizioni i Bashkisë Korçë është kthimi i Korçës në kryeqendër të teknologjisë dhe inovacionit. Për këtë arsye është fokusuar në trajnimin dhe punësimin e të rinjve në tregun global për të punuar si freelancer në kompani të ndryshme të botës. Një numër i caktuar i trajnimeve janë financuar nga buxheti i Bashkisë.

Incentivimin e të rinjve Bashkisë e ka në fokus të punës së saj, nëpërmjet paketës fiskale.

Përmbushja e këtij prioriteti vlerësohet me 100%.

Prioriteti 4: Ritja e ndihmës për grupet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.

Programi i Bashkisë Korçë, Përkujdesi Social ka si qëllim krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale në nivel vendor për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Ndërtim dhe administrim i qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore. Ofrimi i përfitimeve në para dhe në natyrë për të siguruar mbrojtje shoqërore për personat e papunësuar, marrja e masave për të riintegruar personat e papunë në tregun e punës dhe për të zvogëluar rrezikun e papunësisë të grupeve të veçanta. Strehim i përshtatshëm për njerëzit në nevojë, ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social.

Përmbushja e prioritetit 4, në mënyrë progresive për periudhën 2021- 2023 vlerësohet 90%.

Prioriteti 5 : Trajtim me prioritet i programeve që nxisin përmirësimin e kushteve të jetesës, strehimin dhe integrimin në punë dhe shoqëri të komunitetit Rom dhe Egjiptian.

- Vazhdojnë nga shkurt 2022 të funksionojnë edhe për këtë periudhë monitorimi 4 qendra ditore për të moshuarit, ku kapaciteti akomodues është 170 persona, 60 prej të cilëve janë të moshuar rom dhe egjiptian.
- Në stafin e Bashkisë punojnë 13 punonjës të komuniteteve Rom dhe Egjiptian, një tregues përse i përket çështjeve të pakicave.
- Në kuadër të programit ROMACTED II dhe kontribut në natyrë të Bashkisë janë mundësuar për individë nga komuniteti Rom dhe Egjiptian sesione informuese në lidhje me mundësitë e ndryshme që lidhen me programet publike të punësimit, për shëndetin dhe aksesin në shërbimet shëndetësore, kurs falas për *social media*, për 12 të rinj, seanca mentorimi për orientim karriere për 10 të rinj.

Pavarsisht se kërkesa e arrdhur nga ky komunitet, që fëmijët rom dhe egjiptian të regjistrohen dhe të frekuentojnë kopshtet me drekë pa pagesë, pavarësisht statusit të papunë të prindit nuk është përmbushur, këta fëmijë kanë marë mbështetje dhe ndihmë në forma të tjera. Bashkia Korçë administron 3 qendra ditore për fëmijë në bashkëpunim me Misionin Emanuel. Këto qendra për periudhën kohore janar-gusht 2023 i kanë frekuentuar 100 fëmijë rom dhe egjiptian.

Pavarsisht faktit që gjatë vitit 2021 është ndëhyrë për ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve për ujrat e përdorura edhe për instalime hidro sanitare tek ish Gjeologjia Korçë situata nuk është e kënaqëshme.

Përmbushja progresive e Prioritetit 5 vlerësohet 80%.

Prioriteti 6 : Bashkia të ndërtojë mekanizma të unifikuar dhe efektiv për Buxhetimin me Pjesëmarrje, për të identifikuar sa më shumë problematika që lidhen me komunitetin, të marrë këndvështrimin e qytetarëve mbi vendimarrjet më të rëndësishme.

Për periudhën që ky raport monitoron, Bashkia Korçë ka zhvilluar rregullisht gjatë vitit 2022 takimet për Buxhetimin me Pjesëmarrje me qytetarët e njësive të ndryshme administrative, por mundet të përmendim takimin konsultativ edhe me bizneset.

Bashkia Korçë ka realizuar një sondazh online për mbledhjen dhe identifikimin e prioriteteve të qytetarëve, me qëllim që prioritetet e qytetarëve të reflektohen që në fazën e hartimit të Tavanëve Përgatitore Buxhetore për PBA 2024-2026.

Për këtë prioritet duhet të bëhen më tepër përpjekje nga Bashkia për të gjetur forma dhe mekanizma të reja për të identifikuar sa më shumë problematika që lidhen me komunitetin.

Duke vlerësuar përmbushjen e prioriteteve në mënyrë progressive për periudhën shtator 2021- shtator 2023, rezulton se prioriteti 6 është përmbushur me 77 %.

Analiza e detajuar e gjetjeve për secilin Prioritet sipas Kontratës Sociale

Gjetjet nga monitorimi dhe informacioni i Bashkisë Korçë

Prioriteti 1:

Ndërrhyrje me investime që përmirësojnë infrastrukturën dhe rrugët dytësore, për bashkinë Korçë.

Janë shtruar dhe riparuar 6,500 m² trotuare në qytet, 3,000 m² më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar dhe janë vendosur 4,382 m² pllaka betoni trotuari, 3,182 m² më shumë se periudha e njëjtë e vitit të kaluar.

Rajoni 1: Përmirësim i trotuareve tek Rr. "Theodhor Kavaljoti", Lagjia 10 (Blloku i Francezëvë), ku jetojnë 29 familje të komunitetit Rom, përmirësimi i ndriçimit dhe pastrimit.

Në lagjen nr.10 të qytetit, është zbatuar një prej projekteve më të mëdha infrastrukturore të Bashkisë Korçës. Pas përmbylljes së punimeve në rrjetin e kanalizimeve, janë asfaltuar edhe sipërfaqe trotuare.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe monitorimi është përmirësuar ndjeshëm ndriçimi dhe pastrimi në Lagjen 10.

Rajoni 2: Asfaltimi i rrugëve "Mihal Ciko", "Naum Karanxha", "Koli Çeku" (Laj. 4). Paisja me trotuare i rrugëve "Naum Karanxha", "Koli Çeku" dhe "Aleksandra Ilo" (Laj.4)

Janë asfaltuar dhe janë pajisur me trotuarë rrugët e lagjes 4. Kanë ngelur pa përfunduar disa akse tek "Naum Karanxha", "Koli Çeku" për arsye sepse janë në pronësi private.

Gjithsesi mundet të thuhet që ky prioritet është adresuar nga Bashkia e cila është e angazhuar për ti dhënë zgjidhje.

Rajoni 3: Asfaltimi i rrugëve “Thanas Rëmaçka” (Lgj.6) dhe rrugët dytësore tek rruga e Leshpunueses (Lagj.18).

Janë asfaltuar të gjitha rrugët e lartpërmendura.

Njësia administrative Qendër Bulqarec: Ndërhyrje për të asfaltuar rrugët që lidhin fshatin me zonat jashtë njësisë administrative. Konkretisht, rruqa Bulqarec-Çifliq është e paasfaltuar, ndërsa rruqa Bulqarec-Shamoll ka vetëm një shtresë të shtruar me çakull. Të pajisen rrugët kryesore të fshatit me trotuare dhe specifikisht në Rrugën e Krishterëve. Pajisja me ndriçim i të gjitha rrugëve të fshatit Bulqarec. Ka mungesë ndriçimi në 20% të rrugëve të fshatit, atje ku ka shtëpi të veçuara. Paisja me ndriçim tek Rruqa Nacionale që përfshin zonën prej Urës së Dunavecit, deri tek “Delta”.

Është zgjidhur problemi i ndriçimit në rrugët duke bërë vendosjen e ndriçuesve LED. Mbetet vetëm të bëhet lidhja e tyre.

Nuk është realizuar paisja me ndriçim tek Rruqa Nacionale që përfshin zonën prej Urës së Dunavecit, deri tek “Delta”, por jo nuk është kompetencë e Bashkisë Korçë.

Ngelet për tu adresuar në vazhdim asfaltimi i rrugës Bulqarec-Çiflig e cila vazhdon të jetë ende e paasfaltuar, pra vetëm e çakulluar. Në të njëjtën situatë është edhe rruga Bulqarec-Shamoll, të cilës i janë bërë disa shtresa çakullimesh, por ende nuk është e asfaltuar.

Njësia administrative Drenovë

Fshati Mborje: Asfaltimi i rrugës prej shkollës deri në qendër dhe Rr. “Pavlo Sholla”. Sistemimi i ujrave të zeza në rrugën e Koresë, Ulicës dhe Kasabasë. Paisja e rrugëve me ndriçim, sepse ka ndriçim vetëm në rrugët kryesore.

Gjatë kësaj periudhe monitorimi janë shtuar ndjeshëm shtyllat dhe sipërfaqet e ndriçuara në fshatin Mborje.

Mbetet problem i pazgjidhur sistemimi i ujrave të zeza, i cili sipas organizimit të ri nuk është kompetencë e NSHP-së, por Bashkia Korçë duhet të gjejë zgjidhjen e këtij problemi.

Njësia administrative Mollaj. Fshati Mollaj: Asfaltimi i rrugës së Sallatashit. Përfundimi i rrugëve “Haxhi Sherif” dhe “Xhamia”. Shtrimi i rrugëve drejt parcelave bujqësore.

Janë shtruar rrugët me asfalt si dhe janë çakulluar rrugët e parcelave.

Prioriteti 2 :

Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar.

Njësia administrative Korçë (Qyteti Korçë)

• Rikonstruksioni i gjimnazit "Themistokli Gërmenji" : ndërrimi i dritareve, të cilat janë shumë të amortizuara dhe ulin efikasitetin e ngrohjes qatë muajve të dimrit dhe ndërrimi i kaldajës. Rikonstruksion i dritareve dhe tualeteve tek gjimnazit Gjimnazi 3, brenda ambienteve të së cilës ka shumë laqështi duke ndikuar në ngrohje. Ndërtimi i një palestre për këtë shkollë. Ndërrhyrje në ambientet e brendshme të shkollës nëntëvjeçare "Asdreni", si dhe tek këndi sportiv i saj, i cili është jashtë parametrave sportivë. Rikonstruksioni i shkollës "Ismail Qemali".

- Ka përfunduar rikonstruksioni dhe shtesa e shkollës së mesme "Themistokli Gërmenji", projekt me bashkëfinancim me fondet e buxhetit të shtetit dhe Bashkisë Korçë. Projekti përfshin transformimin rrënjësor të ambienteve, ndërtimin e një palestre të re, kabinete të reja laboratorike dhe vendosjen e të gjitha paisjeve të nevojshme për zhvillimin e mësimin në standarde bashkëkohore. Totali i investimit 98,095,805 Lekë.

Shuma me TVSH për rinkonstruktimin e shkollës sipas kontratës: 75,565,671 Lekë.¹⁰ Financimi i Bashkisë për këtë projekt, në total 24,743,000 Lekë.

Tashmë, procesi i rikonstruksionit ka përfunduar, dhe nxënësit vazhdojnë frekuentimin në ambjentet e saj, megjithatë, vazhdojnë të ekzistojnë detaje dhe mungesa që po adresohen në vazhdimësi.

Shuma me TVSH për terrenet sportive dhe punime të tjera, shkolla "Themistokli Gërmenji sipas kontratës: 18,340,134 Lekë.¹¹

Shtrim me parket të palestrës së shkollës "Themistokli Gërmenji" Shuma me TVSH 3,616,800 Lekë.¹²

- Janë realizuar ndërhyrje në ambientet e shkollës nëntëvjeçare "Asdreni", si dhe tek këndi sportiv i saj.
- Ka filluar rikonstruksioni i shkollës së mesme "Ymer Dishnica" (Gjimnazi 3).

Shuma me TVSH për rinkonstruktimin e shkollës 17,273,473 Lekë.¹³

Ka ngelur pa adresuar rikonstruksioni i shkollës "Ismail Qemali".

¹⁰ <https://prokurimettransparente.al/en/tender/view/id/47985>

¹¹ <https://prokurimettransparente.al/en/tender/view/id/52005>

¹² <https://prokurimettransparente.al/en/tender/view/id/52691>

¹³ <https://prokurimettransparente.al/en/tender/view/id/52274>

Njësia administrative Qendër Bulgarec

Shtimi i numrit të tualeteve në shkollën e fshatit Bulgarec, të cilat përdoren nga tre grupmosha të ndryshme. (kopësht, arsimi i mesëm i ulët dhe arsimi i mesëm i lartë). Ka pamjaftueshmëri të tualeteve në këtë shkollë. Ndërtimi i një palestres dhe një ambienti për arqetim dhe lojra jashtë orarit shkollor. Për këtë qëllim u propozua nga banorët që të shfrytëzohet një mjedis i lirë pranë shkollës.

Në NJA Bulgarec, e vetmja nga nënçështjet e prioritetit 2 e cila rezultonte e papërbushur gjatë periudhës së monitorimit 2021- 2022 ishte ndërtimi i palestres të shkollës së këtij fshati. Gjatë kësaj periudhe monitorimi edhe kjo çështje është adresuar. Është planifikuar ndërtim shtesë për palestën.

Njësia administrative Drenovë

Ndërtimi i një këndi sportiv në shkollën e fshatit Mborje në territorin pas shkollës.

Nuk ka patur ndërhyrje përsa i përket ndërtimit të një këndi sportiv në shkollën e fshatit Aktualisht po bëhet termoizolimi i jashtëm i Shkollës “Haki Mborja “, në fshatin Mborje.

Njësia administrative Mollaj

Shtimi i numrit të tualeteve në shkollën e fshatit Mollaj, të cilat përdoren nga tre grupmosha të ndryshme. Izolimi i laqështisë tek shkolla e fshatit Mollaj, e cila ka ajër shumë të rënduar për shkak të laqështisë dhe amortizimit.

- *Ka përfunduar terreni sportiv tek Shkolla “Isuf Dalipi”, në Mollaj. Është realizuar ndarja e ambjentëve të kopshtit nga ato të shkollës dhe është duke u punuar për tualetet.*

Shuma me TVSH për terrenin sportiv sipas kontratës: 1,247,702 Lekë.¹⁴

Prioriteti 3:

Nxitja e politikave të punësimit për të rinjtë nëpërmjet incentivave për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës për ta.

Një nga lehtësitë që u është ofruar të rinjve me qëllim nxitjen e biznesit është përjashtimi nga pagesat e tarifave për vitin 2023 të gjithë subjekteve të cilat zhvillojnë për herë të parë aktivitet dhe regjistrohen nga studentë të diplomuar në universitete brenda dhe jashtë vendit.

Vizioni i Bashkisë Korçë është kthimi i Korçës në kryeqendër të teknologjisë dhe inovacionit. Për këtë arsye është fokusuar në trajnimin dhe punësimin e të rinjve në tregun global për të

¹⁴ <https://prokurimettransparente.al/en/tender/view/id/50204>

punuar si freelancer në kompani të ndryshme të botës. Një numër i caktuar i trajnimeve janë financuar nga buxheti i Bashkisë.

Në këtë kuadër mundet të përmendim:

- Mbështetje financiare të aplikantëve (banorë të Bashkisë Korçë) në vijim të programit të qeverisë shqiptare “Programi i Kodimit” që ka si qëllim aftësimin e të rinjve në fushën e programimit dhe teknologjive, ku numri i pjesëmarrësve që e frekuentojnë këtë program për vitin 2023, është 40 persona.
- Rritja e ndjeshme e numrit të të rinjve (mbi 1000 të rinj), të cilët kanë frekuentuar programet që lidhen me teknologjinë e informacionit (programim, zhvillim website, graphic design, robotikë, etj) të ofruara pranë Hub-it të Teknologjisë së Informacionit, Korçë. Falë prezantimit nga të rinjtë të projekteve inovative në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe punës së palodhur të të rinjve të talentuar, Korça është shndërruar në një model suksesi, jo vetëm rajonal, por edhe kombëtar.
- Mbështetja nga Bashkia e nxënësve ekselentë me bursa me qëllim lehtësimin e barrës financiare në shkollim, zhvillimin personal dhe profesional.

Prioriteti 4:

Ritja e ndihmës për grupet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.

Për tu arritur në ndihmë grupeve në nevojë Bashkia Korçë zbaton programet e mëposhtëme:¹⁵ &¹⁶&¹⁷

Bashkia Korçë për të disatin vit, organizon projektin “Karta për pensionistët”, ku mundëson transportin urban falas për pensionistët. Gjatë 8 muorit të parë të vitit 2023 janë shpërndarë 245 karta.

Gjatë vitit 2023 kanë patur ulje dhe përjashtime nga pagesa e tarifave vendore për subjekte të ndryshme dhe përjashtimë për familjet në nevojë.

Janë përjashtuar nga pagesa e tarifave vendore pastrim, ndriçim për vitin 2022 dhe 2023 :

- të gjitha familjet në fshatrat e njësive administrative, në të cilat nuk kryhen këto shërbime;
- të gjithë familjet, kryefamiljarët e të cilave përfitojnë ndihmë ekonomike;
- të gjithë familjet, kryefamiljari i të cilave përfiton vetëm pension pleqërie / pension social, kur familja përbëhet vetëm nga 1 pensionist.

¹⁵ RAPORTI I MONITORIMIT BASHKIA KORÇË, JANAR-GUSHT 2022:

https://docs.google.com/document/d/1hDg7maHV5KSR0Q-1oaa1EW_8_8agf71p/edit

¹⁶ RAPORTI I MONITORIMIT BASHKIA KORÇË, JANAR-DHJETOR 2022:

<https://docs.google.com/document/d/1APTUJaE2F0Na4d4YTR7C7aRwepkK4I8b/edit>

¹⁷ RAPORTI I MONITORIMIT BASHKIA KORÇË, JANAR-GUSHT 2023:

<https://docs.google.com/document/d/15p8l77pjE6JmPmKxj-MTI3oG8liHikIN/edit>

Programi i Bashkisë Korçë, Përkujdesi Social ka si qëllim krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale në nivel vendor për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Ndërtim dhe administrim i qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore. Ofrimi i përfitimeve në para dhe në natyrë për të siguruar mbrojtje shoqërore për personat e papunësuar, marrja e masave për të riintegruar personat e papunë në tregun e punës dhe për të zvogëluar rrezikun e papunësisë të grupeve të veçanta. Strehim i përshtatshëm për njerëzit në nevojë, ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social.

Shërbimet te ky program kryhen nga Bashkia, Shtëpia e Foshnjës, Qendra Ditore e Zhvillimit dhe Qendra Rezidenciale e Zhvillimit.

Realizimi i shpenzimeve për këtë program për periudhën janar-gusht 2023 ka qenë 26,736 mijë lekë ose realizuar në masën 52% kundrejt planit të periudhës 51,271 mijë lekë dhe 37% kundrejt planit vjetor të vitit 2023, në vlerën 72,621 mijë lekë.

Për periudhën janar-gusht 2023:

- ✓ Në bashkëpunim me Misionin Emanuel vazhdojnë të ofrohen shërbime në 4 qendra ditore për të moshuarit, ku kapaciteti akomodues është 170 persona, ku 138 i përkasin gjinisë mashkullore dhe 32 i përkasin gjinisë femërore, të moshuar rom/egjiptian janë 60. Në krahasim me periudhën e mëparshme të monitorimit 2021- 2022, numri për këtë periudhë monitorimi është rritur me 5 persona që i përkasin gjinisë mashkullore.
- ✓ Bashkia Korçë edhe për këtë periudhë monitorimi vazhdon të administrojë 3 qendra ditore për fëmijë në bashkëpunim me Misionin Emanuel. Këto qendra për periudhën kohore Janar – Gusht 2023 i kanë frekuentuar 100 fëmijë, nga të cilët 61 janë të gjinisë femërore dhe 39 të gjinisë mashkullore.
- ✓ Bashkia edhe për këtë periudhë monitorimi ka vazhduar të mbulojë shpenzimet për energji, ujë, telefon, internet dhe karburant për Qendrën e Kujdesit Paliativ Korçë Mary Potter. Kjo qendër kujdeset me përkushtim jo vetëm për përmirësimin e jetës së pacientëve me sëmundje malinje gjatë gjithë ecursisë së sëmundjes, por edhe të familjarëve të tyre.
- ✓ 2,832 persona janë mbështetur me pagesë invaliditeti.
- ✓ 2,313 persona kanë përfituar pagesë për paaftësi, të verbër, para dhe tetra plegjikë dhe kujdestarët e tyre.
- ✓ 58 familje mesatarisht çdo muaj janë përfituese të ndihmës ekonomike nga 6% i fondit të kushtëzuar.
- ✓ 38 gra kryefamiljare kanë përfituar nga kategoria 6% i fondit të kushtëzuar dhe nga kategoria 3% e fondit nga buxheti vendor.

- ✓ 15 familje në nevojë, që nuk janë fituese nga sistemi, çdo muaj mesatarisht kanë qenë përfitues të ndihmës ekonomike nga fondi i buxhetit vendor.
- ✓ 20 përfitues për kredinë e butë, 21 për bonusin e qirasë, 44 për përmirësimin e kushteve në banesa. 3 përfitues për grantin e menjëhershëm nga viti 2022 dhe 21 aplikantë për grantin e menjëhershëm për vitin 2023).

Në lidhje me Prioritetin 4, rezultojnë edhe përfituesit si më poshtë:¹⁸

- Bashkia ka rritur numrin e punonjësve socialë në Drejtorinë e Kujdesit Social për të përmirësuar shërbimet dhe cilësinë ndaj grupave në nevojë. Në Qendrën Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara, është përfshirë një punonjës shtesë, ndërsa në kujdesin social është filluar Programi për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF), me një punonjëse për mbrojtjen e fëmijëve dhe një specialist për barazinë gjinore.
- Janë ndihmuar me paketa ushqimore 20 familje në nevojë (gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2023).
- Është ofruar ndihmë për restaurimin e shtëpisë së një familjeje në Njësinë administrative Drenovë, e cila u dëmtua nga zjarri.
- 150 fëmijë kanë patur mundësinë për të marrë pjesë në kampin veror falas gjatë korrikut të vitit 2023.
- 180 të moshuar vetëm në qendrat ditore për moshën e tretë vazhdojnë të marrin shërbimin ditor falas.
- 25 fëmijë nga familjet në nevojë kanë përfituar nga kopshti falas gjatë vitit shkollor 2022-2023, dhe 20 fëmijë do të kenë këtë mundësi gjatë vitit shkollor 2023-2024.
- 100 fëmijë në nevojë kanë marrë pajisje shkollore falas edhe për vitin shkollor 2023-2024, me qëllim të parandalimit të braktisjes shkollore.

Gjithashtu:

- Ka filluar hartimi i një plani të ri social, gjatë vitit 2023, duke rishikuar më në detaj shërbimet për grupet në nevojë.
- Në përpjekje për deinstitutionalizimin e fëmijëve, një familje kujdestare pa lidhje gjaku është përzgjedhur nga komisioni i mbrojtjes sociale, brenda bashkisë, për të marrë përkohësisht në kujdes dy fëmijë (motër dhe vëlla) nga Shtëpia e Foshnjës 'Lulet e Vogla'.
- Bashkëpunimi me Zyren e Punësimit ka sjellë punësimin e 15 individëve përmes programit të ndihmës ekonomike, me qëllim integrimin e tyre në tregun e punës komunitar.

¹⁸ Informacion i ofruar nga Drejtoria e Kujdesit Social, Bashkia Korçë

- 20 gra me urdhër mbrojtje nga gjykata kanë marrë mbështetje psikologjike, këshillime dhe pako ushqimore, gjatë 6 muajve të parë të vitit 2023.
- Shërbimi mbështetës për familjen dhe fëmijën, i cili është një strukturë e ngritur brenda Drejtorisë së Kujdesit Social, ka ofruar shërbime psikologjike, ndihmë për detyrat pas mësimet, dhe ndihmë direkte me ushqime dhe veshmbathje për 45 fëmijë në nevojë, duke përfshirë klasa prindërimi për prindërit e tyre.
- 33 fëmijë në nevojë kanë marrë shërbime në Qendrën Komunitare të Aftësisë së Kufizuar, duke përfshirë logopedi, fizioterapi dhe terapi zhvillimi. Po ashtu, 100 fëmijë në nevojë kanë marrë shërbime nga qendrat ditore komunitare, duke përfshirë ushqim, mbështetje për mësimet dhe aktivitete psiko-sociale."
- Për përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të pa favorizuara Bashkia Korçë ka vënë në dispozicion shumën me TVSH 25,465,502 Lekë.¹⁹

Prioriteti 5:

Trajtim me prioritet i programeve që nxisin përmirësimin e kushteve të jetesës, strehimit dhe integrimin në punë dhe shoqëri të komunitetit Rom dhe Egjiptian.

Strehimi: Zona e ish-Gjeologjikes, konvikti i shkollës bujqësore, konvikti tek shkolla "Demokracia". Për momentin kërkohet nga qytetarët dezinfektimi i ambienteve, t'u sigurohet ujë i pijshëm dhe restaurim i konvikteve ku ata banojnë në këto zona.

Pavarsisht faktit që gjatë vitit 2021 është ndëhyrë për ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve për ujrat e përdorura edhe për instalime hidro sanitare tek ish Gjeologjia Korçë situata nuk është e kënaqëshme.

Për familjet e komunitetit Rom dhe Egjiptian të strehuara në zonat e ish Gjeologjikes, konvikti i shkollës bujqësore, apo ish konvikti i ndërtimit, Bashkia sugjeron zgjidhje nëpërmjet instrumentit financiar të subvencionimit të qirasë sociale, individët/familjet e strehuara në këto objekte të sigurojnë një kontratë të qiradhënies dhe më pas të mbështetet me pagesën e qirasë për strehim në kushtet e një apartamenti në përputhje me të gjitha parimet e strehimit social.

Nga takimet e organizuara nga GZHK, në të cilat kanë marrë pjesë anëtarë të këtij komuniteti, rezulton se qytetarët e këtyre zonave jo vetëm që nuk plotësojnë kriteret për të përfituar nga banesat sociale për faktin sepse nuk kanë mundësi për shlyerjen e kredisë, por për ta është shumë e vështirë të sigurojnë edhe një kontratë qiradhënie për shkak të paragjyqimeve kundrejt tyre.

¹⁹ <https://prokurimettransparente.al/en/tender/view/id/52639>

Vazhdojnë nga shkurt 2022 të funksionojnë edhe për këtë periudhë monitorimi 4 qendra ditore për të moshuarit, ku kapaciteti akomodues është 170 persona, 60 prej të cilëve janë të moshuar rom dhe egjiptian.

Në stafin e Bashkisë punojnë 13 punonjës të komuniteteve rom dhe egjiptian, një tregues përse i përket çështjeve të pakicave.

Arsimi: Kërkohet që t'u jepet mundësi fëmijëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian të regjistrohen dhe të frekuentojnë kopshtet me drekë pa pagesë, pavarësisht statusit të papunë të prindit.

Në kuadër të programit ROMACTED II bashkia Korçë në bashkëpunim me Shoqatën « Gruaja në Zhvillim Korçë » ka mundësuar për individë nga komuniteti Rom dhe Egjiptian:

- ✓ Sesione informuese për 14 nëna të reja dhe 15 të rinj nga komuniteti Rom dhe Egjiptian në lidhje me mundësitë e ndryshme që lidhen me programet publike të punësimit.
- ✓ Sesione informuese për shëndetin dhe aksesin në shërbimet shëndetësore për 27 nëna dhe të reja.
- ✓ Një kurs falas për *social media*, i cili u ndoq nga 12 të rinj.
- ✓ Seanca mentorimi për orjentim karriere për të 10 të rinj.

Bashkia për realizimin e projektit vuri në dispozicion ambiente dhe infrastrukturën e nevojshme.

Gjithashtu Bashkia ka organizuar aktivitete të ndryshme për këtë komunitet. Nxënësit e shkollave të mesme nga komuniteti Rom&Egjiptian përfitojnë librat falas, bursa të vogla si ndihmë ekonomike.

Kërkesa e ardhur nga ky komunitet, që fëmijët Rom& Egjiptian të regjistrohen dhe të frekuentojnë kopshtet me drekë pa pagesë, pavarësisht statusit të papunë të prindit nuk është përmbushur. Këta fëmijë kanë marrë mbështetje dhe ndihmë në forma të tjera. Bashkia Korçë administron 3 qendra ditore për fëmijë në bashkëpunim me Misionin Emanuel. Këto qendra për periudhën kohore janar-gusht 2023 i kanë frekuentuar 100 fëmijë rom dhe egjiptian.

Prioriteti 6 :

Bashkia të ndërtojë mekanizma të unifikuar dhe efektiv për Buxhetimin me Pjesëmarrje, për të identifikuar sa më shumë problematika që lidhen me komunitetin, të marrë këndvështrimin e qytetarëve mbi vendimmarrjet më të rëndësishme.

Bashkia Korçë në kuadër të programit “Bashkia për qytetarët” organizon çdo vit “Buxhetimin me pjesëmarrje”. Buxhetimi me pjesëmarrje është një mekanizëm që lejon qytetarët të marrin pjesë në vendimmarrje dhe ngritjen e transparencës në procesin e hartimit të buxhetit. Në takimet e hapura që zhvillohen me banorët e qytetit dhe njësisive administrative, qytetarëve u krijohet mundësia për të diskutuar mbi projektbuxhetin dhe Paketën Fiskale. Kjo praktikë financiare ka për qëllim të rritë pjesëmarrjen e zërit të qytetarëve, si dhe ndihmon qeverisjen vendore për të përmirësuar përgjegjësinë mbi buxhetin. Buxhetimi me Pjesëmarrje i ofron mundësinë qytetarëve për të vendosur së bashku me pushtetin vendor për prioritetet më të rëndësishme në zonën ku ata banojnë.

Për periudhën që ky raport monitoron, Bashkia Korçë ka zhvilluar rregullisht gjatë vitit 2022 takimet për Buxhetimin me Pjesëmarrje me qytetarët e njësisive të ndryshme administrative, por mundet të përmendim takimin konsultativ edhe me bizneset.

Nga data 2 -28 Shkurt 2023 Këshilli i Bashkisë Korçë organizoi një sondazh online për mbledhjen dhe identifikimin e prioriteteve të qytetarëve, me qëllim që prioritetet e qytetarëve të reflektohen që në fazën e hartimit të Tavanëve Përgatitore Buxhetore për PBA 2024-2026.

Për këtë prioritet duhet të bëhen më tepër përpjekje nga Bashkia për të gjetur forma dhe mekanizma të reja për të identifikuar sa më shumë problematika që lidhen me komunitetin.


Vlerësim i thelluar dhe Përfundime

Ajo çfarë mund të prezantojmë në këtë fazë është se Bashkia ka treguar seriozitet dhe angazhim në përmbushjen e prioriteteve dhe ky fakt reflektohet në përmbushjen e 85.3 % të prioriteteve të hartuara në Kontratën Sociale të firmosur në korrik 2021, në përfundim të kësaj periudhe monitorimi.

Qasja e qytetarëve të Korçës për t’u bërë pjesë e monitorimit dhe diskutimet në fokus-grupet e realizuara pësoi një rritje. Shoqata “Gruaja në Zhvillim Korçë” do të vijojë përsëri monitorimin e punës së Bashkisë, drejtorive përkatëse, si edhe vendimeve të Këshillit Bashkiak pranë kësaj Bashkie, por në vazhdim do të monitorojë Kontratën e re sociale 2023-2027.


Anekse

Aneks 1. Paraqitja grafike e rezultateve finale të Kontratës Sociale, Bashkia Korçë



Aneks 2. Kontrata Sociale e detajuar

KONTRATA SOCIALE



POP
PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE

PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE

PRIORITETET E KOMUNITETIT BASHKIA KORÇË

27 KORRIK 2021

Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të 12 organizatave të shoqërisë civile shqiptare

Prioritet 1:

Ndërhyrje me investime që përmirësojnë infrastrukturën dhe rrugët dytësore, për bashkinë Korçë në njësitë e mëposhtme:

Njësia administrative Korçë (Qyteti Korçë)
Vendosja e sinjalistikave, tek Trekëndëshi dhe Dritat e Verdha, pasi shpesh kanë ndodhur aksidente. Lagjja 15 ka nevojë për semafor, pasi po bëhet burim aksidentesh.
Rajoni 1: Përmirësimi i trotuareve tek Rr. "Theodor Kavaljoti", Lagjja 10 (Biloku i Francezëvë), ku jetojnë 29 familje të komunitetit Rom, përmirësimi i ndriçimit dhe pastrimit.
Rajoni 2: Asfaltimi i rrugëve "Mihal Ciko", "Naum Karanxha", "Koli Çeku" (Lgj. 4). Paisja me trotuare i rrugëve "Naum Karanxha", "Koli Çeku" dhe "Aleksandra Ilo" (Lgj. 4).
Rajoni 3: Asfaltimi i rrugëve "Thanas Rëmaçka" (Lgj.6) dhe rrugët dytësore tek rruga e Leshpunueses (Lagj.18).

Njësia administrative Qendër Bulgarec
Ndërhyrje për të asfaltuar rrugët që lidhin fshatin me zonat jashtë njësisë administrative.
Konkretisht, rruga Bulgarec-Çiflig është e paasfaltuar, ndërsa rruga Bulgarec-Shamoll ka vetëm një shtresë të shtruar me çakull. Të pajisen rrugët kryesore të fshatit me trotuare dhe specifikisht në Rrugën e Krishterëve. Pajisja me ndriçim i të gjitha rrugëve të fshatit Bulgarec. Ka mungesë ndriçimi në 20% të rrugëve të fshatit, atje ku ka shtëpi të veçuara. Paisja me ndriçim tek Rruga Nacionale që përfshin zonën prej Urës së Dunavecit, deri tek "Delta".

Njësia administrative Drenovë
Fshati Mborje: Asfaltimi i rrugës prej shkollës deri në qendër dhe Rr. "Pavlo Sholla". Sistemimi i ujrave të zeza në rrugën e Koresë, Ulicës dhe Kasabasë. Paisja e rrugëve me ndriçim, sepse ka ndriçim vetëm në rrugët kryesore.

Njësia administrative Mollaj.
Fshati Mollaj: Asfaltimi i rrugës së Sallatashit. Përfundimi i rrugëve "Haxhi Sherif" dhe "Xhamia". Shtrimi i rrugëve drejt parcelave bujqësore.

Prioritet 2: **Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar.**

Njësia administrative Korçë (Qyteti Korçë)

- Rikonstruksioni i gjimnazit "Themistokli Gërmenji": ndërimi i dritareve, të cilat janë shumë të amortizuara dhe ulin efikasitetin e ngrohjes gjatë muajve të dimrit dhe ndërimi i kaldajës. Rikonstruksion i dritareve dhe tualeteve tek gjimnazit "Isuf Gjata" (Gjimnazi 3), brenda ambienteve të së cilës ka shumë lagështi duke ndikuar në ngrohje. Ndërtimi i një palestere për këtë shkollë.
- Ndërhyrje në ambientet e brendshme të shkollës nëntëvjeçare "Asdreni", si dhe tek këndi sportiv i saj, i cili është jashtë parametrave sportivë. Rikonstruksioni i shkollës "Ismail Qemali".

Njësia administrative Qendër Bulgarec
Shtimi i numrit të tualeteve në shkollën e fshatit Bulgarec, të cilat përdoren nga tre grupmosha të ndryshme. (kopësht, arsimit i mesëm i ulët dhe arsimit i mesëm i lartë). Ka pamjaftueshmëri të tualeteve në këtë shkollë. Ndërtimi i një palestere dhe një ambienti për argëtim dhe lojra jashtë orarit shkollor. Për këtë qëllim u propozua nga banorët që të shfrytëzohet një mjedis i lirë pranë shkollës.

Njësia administrative Drenovë
Ndërtimi i një këndi sportiv në shkollën e fshatit Mborje në territorin pas shkollës.

Njësia administrative Mollaj Shtimi i numrit të tualeteve në shkollën e fshatit Mollaj, të cilat përdoren nga tre grupmosha të ndryshme. Izolimi i lagështisë tek shkolla e fshatit Mollaj, e cila ka ajër shumë të rënduar për shkak të lagështisë dhe amortizimit.

Prioritet 3: **Nxjtja e politikave të punësimit për të rinjtë nëpërmjet incentivave për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës për ta.**

Prioritet 4: **Ritja e ndihmës për grupet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.**

Mborje: Kërkohej të jepet ndihmë për strehim për familjet në nevojë dhe sidomos atyre me fëmijë me nevoja të veçanta.
Korçë: Të ketë më shumë shërbime për gratë me fëmijë me aftësi të kufizuara. Për këto familje të paktën njëri nga prindërit të jetë i siguruar ose i punësuar; Përmirësimi i kushteve tek Qendra e të moshuarve.


Prioritet 5: **Trajtim me prioritet i programeve që nxisin përmirësimin e kushteve të jetesës, strehimin dhe integrimin në punë dhe shoqëri të komunitetit Rom dhe Egjiptian.**

Strehimi: Zona e ish-Gjeologjikes, konvikti i shkollës bujqësore, konvikti tek shkolla "Demokracia". Për momentin kërkohet nga qytetarët dezinfektimi i ambienteve, t'u sigurohet ujë i pijshëm dhe restaurim i konvikteve ku ata banojnë në këto zona.
Arsimi: Kërkohej që t'u jepet mundësi fëmijëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian të regjistrohen dhe të frekuentojnë kopshtet me drekë pa pagesë, pavarësisht statusit të papunë të prindit.


Prioritet 6: **Bashkia të ndërtojë mekanizma të unifikuar dhe efektiv për Buxhetimin me Pjesëmarrje, për të identifikuar sa më shumë problematika që lidhen me komunitetin, të marrë këndvështrimin e qytetarëve mbi vendimmarrjet më të rëndësishme.**

- Të përdorë edhe forma të tjera konsultimi përveç takimeve me komunitetin;
- Të mundësojë përfshirjen e gjerë të komunitetit në këto procese;
- Të raportojë sistematikisht në komunitetet se sa prej mendimeve të tij janë reflektuar në vendimmarrjet e saj.


Shoqata
"Gruaja në Zhvillim Korçë"




Entela MAÇKA



Kryetari i Bashkisë
Korçë



Sotiraj FILO



Referenca

- Faqja zyrtare e Bashkisë Korçë: <https://www.bashkiakorce.gov.al/site/>
- Faqja zyrtare e Këshillit Bashkiak Korçë: <https://www.facebook.com/KeshilliBashkiakKorce/>
- Faqja zyrtare e Kryetarit të Bashkisë: <https://www.facebook.com/filosotiraq/>
- Faqja zyrtare e Rrjetit POP: <https://popnetwork.al/>
- Firmosja e Kontratës Sociale për Bashkinë Korçë:
<https://www.facebook.com/POPNetworkAlbania/photos/pcb.1022029351791444/1022027958458250/>
- Kontrata Sociale për Bashkinë Korçë:
- https://popnetwork.al/.../07/Kontrata-Sociale_Korca-A3.pdf
- Kontrata Sociale 2023- 2027
- <https://popnetwork.al/kontrata-sociale-2023-2027-pop-korce/>
- Forumi public Korçë:
- <https://www.facebook.com/gruajanezhvillimkorce/videos/627488055974002>
- Botimi i parë i monitorimit të Kontratës Sociale, Bashkia Korçë:
https://popnetwork.al/.../01/Raporti_POP_Bashkia_Korce-3.pdf
- Grafikë mbi adresimin e prioriteteve:
<https://www.facebook.com/gruajanezhvillimkorce/photos/a.1572047553053488/3184053258519568/>
- Botimi i dytë i monitorimit të Kontratës Sociale, Bashkia Korçë:
- https://popnetwork.al/korce_raporti-monitorues-i-kontrates-sociale-2022/
- Takimi konsultues për projekt-buxhetin e vitit 2022:
<https://www.facebook.com/gruajanezhvillimkorce/photos/pcb.3092209104370651/3092207221037506>
- RAPORTI I MONITORIMIT BASHKIA KORÇË, JANAR-GUSHT 2023:
- <https://docs.google.com/document/d/15p8l77pjE6JmPmKxj-MTI3oG8liHIkIN/edit>
- Open Data Albanai:
- <https://prokurimettransparente.al/en/tender/view/id/47985>
- <https://prokurimettransparente.al/en/tender/view/id/52005>
- <https://prokurimettransparente.al/en/tender/view/id/52691>
- <https://prokurimettransparente.al/en/tender/view/id/52274>
- <https://prokurimettransparente.al/en/tender/view/id/50204>

- RAPORTI I MONITORIMIT BASHKIA KORÇË, JANAR-GUSHT 2022:
- https://docs.google.com/document/d/1hDg7maHV5KSR0Q-1oaa1EW_8_8agf71p/edit
- RAPORTI I MONITORIMIT BASHKIA KORÇË, JANAR-DHJETOR 2022:
- <https://docs.google.com/document/d/1APTUIaE2F0Na4d4YTR7C7aRwepkK4I8b/edit>
- RAPORTI I MONITORIMIT BASHKIA KORÇË, JANAR-GUSHT 2023:
- <https://docs.google.com/document/d/15p8I77pjE6JmPmKxj-MTI3oG8liHIkIN/edit>
- Informacion i ofruar nga Drejtoria e Kujdesit Social, Bashkia Korçë
- Open Data Albania: <https://prokurimettransparente.al/en/tender/view/id/52639>